



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit, “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë)”, nëpërmjet një huaje prej 42 000 000 eurosh””

(Komision për dhenie mendimi)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka, Fadil Nasufi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Besnik Baraj, Andrea Marto, Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Dorina Cinari – zvmministre Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gjergj Simaku – drejtor i Politikave dhe Strategjisë së Zhvillimit të Energjisë dhe Industrisë, MIE

Kreshnik Strati – drejtor i Projekteve të Huaja, OST

Aurora Vasili – drejtoreshë e PIU, OST

Brikena Jazxhi – përfaqësuese e Ministrisë së Financave

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje të nderuar deputetë!

Përshëndetje të ftuar! Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit, “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë (Tiranë-Prishtinë)”, nëpërmjet një huaje prej 42 000 000 eurosh””.

Të ftuar janë përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ju lutem, znj. zëvendësministre një prezantim të shkurtër të projektligjit.

Dorina Çinari – Kjo marrëveshje ndryshuese vjen për shakk të ndryshimit të datës së disbursimit të huas dhe të ndryshimit të emrit të Ministrisë. Projekti “Linja e transmetimit 400 kilovolt Shqipëri-Kosovë ka nisur në vitin 2010 dhe ndërtimi i kësaj linje ka përfunduar më 16 qershor 2016. Me fondet e mbetura të papërdorura nga kredia e prej 42 milionë eurosh që ishte marrë për këtë projekt, u dakordësuan të përdoren për zgjerimin me 400 kV të nënstacionit të HEC-it Koman. Kështu, ndryshimi i marrëveshjes ka për qëllim shtyrjen e afatit të disbursimit të huas së akorduar nga KfW-ja nëpërmjet marrëveshjes së huas në fjalë, deri në datën 30 dhjetor 2018, me qëllim realizimin e komponentit të këtij projekti që ka të bëjë me zgjerimin e nënstacionit 400 kV të HEC-it Koman.

Gjithashtu, marrëveshja e huas dhe projektit, që ndryshohet me këtë marrëveshje ndryshuese, është lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e cila aktualisht është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pra propozohet gjithashtu edhe ndryshimi i emrit të ministrisë.

Eduard Shalsi – A keni informacion për marrëveshjen mes Kosovës e Serbisë për vënien në operim të kësaj linje?

Dorina Çinari – Po kemi. Serbia ngre problem për vënien në punë të kësaj linje në vazhdimësi dhe po ndërmjetësohet nga Këshilli Rajonal i Energjisë për ta zgjidhur, por akoma nuk është zgjidhur.

Besnik Baraj – Është një problem politik apo ekonomik?

Dorina Çinari – Është problem politik. Linja ka përfunduar.

Eduard Shalsi – Ata pretendojnë që para lidhjes së marrëveshjes për ndërtimin e kësaj linje, duhet të ishte përfshirë edhe pala serbe. Znj. Çinari vazhdoni ta ndiqni ecurinë e EITI-t, duke qenë se e keni drejtuar deri para pak kohe?

Dorina Çinari – Po. Raporti nuk është publikuar akoma për shkak të disa treguesve që lidhen me të njëjtat problematika. Është draftuar një ligj për funksionimin e EITI-t që besoj se është ligj shumë i mirë. Besoj se shumë shpejt do të vijë dhe në parlament. Mendojmë që pas miratimit të ligjit do të jetë shumë më e lehtë puna në atë institucion për hartimin e raporteve dhe mbledhjen e të dhënave.

Eduard Shalsi – Atëhere mendoj se duhet të njihemi me raportin e EITI-t qoftë këtu, qoftë në ambientet e tyre. Besoj se ju mbulonin edhe çështjet që lidhen me energjitë e rinovueshme. Në Komision kanë mbërritur disa shqetësime që lidhen me procesin e licencimit të impianteve solare deri në 2MW. Do të donim të kishim një informacion të detajuar se si ka funksionuar ky process deri tani.

Eglantina Gjermeni – Ju lutem të na sillni një informacion më të gjerë në lidhje me projektligjin e sotëm, konkretisht në lidhje me projektin. Diçka më të zgjeruar.

Eduard Shalsi – Faleminderit për prezantimin. Ju lutem mos harroni informacionin që kërkuam. Votimin do e bëjmë në mbledhjen e rradhës.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA